**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **KOMUNA FERIZAJ**,

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **656-25-2239-5-2-1**

Sa i përket tenderit për: **Ndertimi i mureve mbrojtese ne fshatrat Nerodime, Dremjak, Mirosale dhe Gaçke.**

**NIKA PrO- Ing SH.P.K**
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

***Rr. Rexhep Bislimi, Ferizaj***
(Adresa)

**Ferizaj**
(Vendi)

**70000**
(Kodi postar)

**044 249 864**
(Numri Telefonit)

**N/A**
(Numri i Faks-it)

**Shpend Musa**
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

***nika.proing@gmail.com***
(Adresa elektronike)

***16.05.2025***
*(Data e parashtrimit të kërkesës)*

*(Nënshkrimi dhe vula)*

NIKA PRO-ING SH.P.K FERIZAJ

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

**2. Identifikimi i avokatit**

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

*(Emri i avokatit)*

*(Adresa e plotë)*

*(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)*

*(Adresa elektronike)*

*(Data e parashtrimit të kërkesës)* *(Nënshkrimi dhe vula)*

**3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit**

*[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

| |
|---|
| Njoftimi për kontratë: 21.03.2025<br>Formulari standard për korrigjimin e gabimeve:01.04.2025<br>Hapja e ofertave: 10.04.2025<br>Njoftimi mbi vendimin e AK:30.04.2025<br>Kërkesa për qasje në dokumentacion:30.04.2025<br>Emaili i AK per ofrimin e qasjes ne dokumentacion:05.05.2025 ora 13:14 (pak para përfundimit te afatit per parashtim te ankesës)!!!!!!!!<br>Kërkesa për rishqyrtim:05.05.2025 (orët e fundit/dita e fundit)!!!!!!!<br>Refuzimi i kërkesës për rishqyrtim:06.05.2025<br>Ankesa në OSHP:16.05.2025 |

**4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet**

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po ☐ Jo ☒

| |
|---|
| Procesverbalin e hapjes e kemi pranuar përmes sistemit të E-prokurimit. |

**5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet***

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po ☒ Jo ☐

**6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për*

*Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

| |
|---|
| **Neni 1 Qëllimi**<br>**Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti**<br>**Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskrimini**<br>**Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës**<br>**Neni 25 Trajnimi i Zyrtareve të Prokurimit**<br>**Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve**<br>**Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale**<br>**Nenin 40 të Rregullores Nr. 002/2024**<br>**Neni 97 Shkeljet e rënda të RREGULLORES Nr. 001/2022** |

**7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.*

**Pretendimi 1 - Shkelja e të Drejtës për Qasje në Dokumentacion dhe Parimi i Barazisë në Trajtim**

Me datën 30.04.2025, përmes platformës elektronike e-prokurimi, jemi njoftuar me vendimin e Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. Në përputhje me nenin 7 të **Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik**, kemi dorëzuar kërkesë për qasje në dokumentacionin përkatës te njëjtën ditë pra me datë 30.04.2025, dhe ne mungesë të përgjigjes nga AK, kemi dërguar përsëri email me datë 02.05.2025 për qasje.
Autoriteti Kontraktues, megjithatë, na ka dërguar email pikërisht me datën 05.05.2025 në orën 13:14, pra vetëm **2 ore para skadimit të afatit ligjor** për parashtrim të kërkesës për rishqyrtim (05.05.2025), duke na lënë një kohë të papërshtatshme dhe të PA-ARRITSHME për të shqyrtuar dhe analizuar dokumentacionin në mënyrë të duhur.

AK/ ZPP nuk ka respektuar fare Ligjin për Prokurim Publik dhe Rregulloren Nr. 001/2022 (duke mos ofruar qasje për këtë AP), është për tu habitur fakti se ZPP i Autoritetit Kontraktues nuk ka ofruar qasje për këtë procedurë edhe pas kërkesës sonë përmes platformës elektronike e-prokurim.

**ÇUDI, GUXIMI I ZPP-se, OSE MOSDIJA NGA ANA E TYRE, MBI LIGJIN PER PROKURIM PUBLIK!!!!!!!**

Ky mos lejim/neglizhencë në mos ofrimin e qasjes përbën një **shkelje të parimit të barazisë në trajtim** dhe përbën **diskriminim ndaj nesh si palë e interesuar**, në kundërshtim me:

- Nenin 7 të **Ligjit për Prokurim Publik**, i cili garanton trajtim të barabartë dhe jo-diskriminues për të gjithë OE-të.
- Nenin 7 të **Rregullores Nr. 001/2022**, i cili përcakton qartazi se Autoriteti Kontraktues duhet të ofrojë qasje të shpejtë dhe efikase në dokumentacionin e tenderit dhe dokumentet relevante të procedurës.

**Neni 7**
**Informata Sekrete afariste dhe Qasja në Dokumentacion**
RREGULLORE PËR PROKURIMIN PUBLIK – Versioni i konsoliduar

**7.4 Përveç dokumenteve të klasifikuara si informata sekrete afariste, AK do ti ofroj, çdo pale të interesuar që bënë kërkesë, qasje të shpejtë dhe të arsyeshme në të gjitha të dhënat për aktivitetin e prokurimit.**

Kjo sjellje administrative kufizon të drejtën tonë për të ushtruar një mjet efektiv ligjor brenda afatit të paraparë dhe cenon parimin e transparencës dhe drejtësisë në procedurat e prokurimit publik.

**Neni 97**
**Shkeljet e rënda**
RREGULLORE PËR PROKURIMIN PUBLIK – Versioni i konsoliduar

97.1 Shkelje të rënda konsiderohen:

b. Falsifikimi, fshehja apo eliminimi i dokumenteve gjatë zhvillimit të një procedure të prokurimit;

c. **Mos lejimi dhe/ose neglizhimi i qasjes në dokumenteve zyrtare** sipas kërkesës me shkrim të parashtruar nga pala e interesit kur një qasje e tillë e kërkuar është në përputhje me nenin 10 dhe 11 të Ligjit të Prokurimit Publik.

**Konform Ligjit për Prokurim Publik, veprimet e Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit konsiderohen shkelje të rënda, ku me këtë rast arrijmë deri te revokimi i çertifkatës profesionale të prokurimit.**

**Neni 99**
**Masat disiplinore për shkeljet të rënda**
RREGULLORE PËR PROKURIMIN PUBLIK – Versioni i konsoliduar

99.2 Për shkelje të renda të dispozitave të Ligjit të Prokurimit Publik dhe legjislacionit dytësor duke përfshirë edhe ato të specifikuara në paragrafin 97.1 të kësaj rregullore, Bordi i KRPP-së do të nxjerrë **vendim për anulim të çertifikatës së prokurimit dhe do të kërkojë nga autoriteti kontraktues marrjen e masave disiplinore ndaj personit në fjalë** në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

**Dëshmi ju bashkangjesim kërkesën për qasje të datës 30.04.2025 dhe emailin e kthyer nga AK të datës 05.05.2025 ne ora 13:14.**

Autoriteti Kontraktues përkatësisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit duke mos ofruar qasje në dokumentet e kërkuara nga ne si OE pjesëmarrës në këtë AP, ka tejkaluar kompetencat e saj.

Kërkojmë që ky pretendim të merret seriozisht dhe të bëhet rishqyrtimi i vendimit në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar dhe kërkesat e tenderit të merren masa ndaj Zyrtarit Përgjegjës te Prokurimit konform Ligjit për Prokurim Publik

**Pretendimi 2 - Eliminimi i padrejtë lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional**

Nuk pajtohemi me vendimin për eliminimin tonë nga procedura për arsye të mospërmbushjes së kapacitetit teknik dhe profesional, pasi jemi në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara në **Njoftimin për Kontratë** dhe **Dosjen e Tenderit**.

**Kërkesa e AK:** **Per piken** 5. Luge ngarkuese qe rrotullohet 360 shkalle min 3T - min 1 cope

Ne konform kritereve të përcaktuara kemi dorëzuar dudin doganor për këtë makineri ku qartë shihet se është Luge ngarkuese qe rrotullohet 360 shkalle në kapacitet mbi 3T, përkatësisht 5,400 ton, dmth kemi tejkaluar kërkesat e përcaktuara nga AK.

Kërkojmë që edhe ky pretendim të merret seriozisht dhe të bëhet rishqyrtimi i vendimit në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar dhe kërkesat e tenderit.

**Pretendimi 3-Eliminimi i padrejtë lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional për shkak të kërkesave diskriminuese**

Nuk pajtohemi me vendimin për eliminimin tonë nga procedura e prokurimit lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional, pasi kemi plotësuar **kriteret e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit**, në mënyrë të plotë dhe të dokumentuar.

**Kërkesa e AK:** **Per piken** 9.Rrethoja per sigurine e vendpunishtes ne shenja trafiku dhe sinjalizues me drita led min 120m2;

Ne konform kritereve te përcaktuara kemi dorëzuar marrëveshjen me kompaninë Global Holding SH.P.K dhe **Faturën e Blerjes** ju kemi bashkangjitur.

Është shume e pakuptimtë që në cdo dyqan që shkojmë të blejmë paisje, të kërkojmë dudin doganorë, ngase mjafton fatura e blerjes ku në ofertë kemi **dorëzuar Faturën së bashku me marrëveshjen.**

Kërkojmë që edhe ky pretendim të merret seriozisht dhe të bëhet rishqyrtimi i vendimit në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar dhe kërkesat e tenderit.

**Pretendimi 4-Eliminimi i padrejtë lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional për shkak të kërkesave diskriminuese**

Nuk pajtohemi me vendimin për eliminimin tonë nga procedura e prokurimit lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional, pasi kemi plotësuar **kriteret e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit**, në mënyrë të plotë dhe të dokumentuar.

**Kërkesa e AK:** **Per piken** 12. Kamion kiper me vinç dhe korpe me kapacitet min 10m3 vinci me hapje min 20 m (te deshmohet me atest ose pelqim) - min 1 cope

Ne konform kritereve te përcaktuara kemi dorëzuar marrëveshjen me kompaninë FUSHA SHPK per dy kamionët, ku në dokumentet e dorëzuara nga ana jonë qartë shihet se janë të regjistruara, me police për sigurimin e detyrueshëm si dhe certifikatën e kontrollit teknik të mjeteve rrugore me të gjitha atestet dhe pëlqimet konform kritereve të përcaktuara nga AK.

Gjithashtu kërkojmë që edhe ky pretendim të merret seriozisht dhe të bëhet rishqyrtimi i vendimit në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar dhe kërkesat e tenderit.

**Pretendimi 5 - Eliminimi i padrejtë lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional për shkak të kërkesave diskriminuese**

Nuk pajtohemi me vendimin për eliminimin tonë nga procedura e prokurimit lidhur me mos ofrimin e librezës së regjistrimit, pasi kemi plotësuar **kriteret e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit**, në mënyrë të plotë dhe të dokumentuar.

**Kërkesa e AK:** **Per piken** 13. Kompresor gjysemrimorkio qe terhiqet minn 1.5T - min 1 cope

Pajisjet për të cilat kërkohet regjistrimi **nuk janë mjete të qarkullueshme rrugore**, por mjete pune që përdoren brenda një zone të kufizuar pune (kantier apo vendpunishte), dhe si të tilla **nuk janë të detyruara të posedojnë libreza qarkullimi apo regjistrim rrugor**.
Për më tepër, është **vendimi i qartë i OSHP-së me nr 928/24**, e cila thekson se për mjete që nuk përdoren në rrugë publike, nuk është e domosdoshme të kërkohen libreza qarkullimi – përderisa përdorimi i tyre është i kufizuar në kantier, dhe për aq kohë sa ofrohet dëshmi për posedimin apo qasjen në to.
Ne kemi ofruar të gjitha pajisjet e kërkuara se bashku me dud doganor dhe në **përputhje të plotë me specifikimet teknike** të Autoritetit Kontraktues, mirëpo jemi eliminuar vetëm për shkak se nuk kemi ofruar libreza qarkullimi.
Sërish theksojmë se këto pajisje **nuk janë mjete të qarkullueshme rrugore**, por mjete pune që përdoren brenda një zone të kufizuar pune (kantier apo vendpunishte), dhe si të tilla **nuk janë të detyruara të posedojnë libreza qarkullimi apo regjistrim rrugor por vetëm me dud doganor.**
Ky eliminim është **i padrejtë**, i **pabazuar në ligj**, dhe i mbështetur mbi arsyetime **të paarsyeshme dhe joproporcionale**, që bien ndesh me praktikat e mirëfillta të prokurimit publik.
Kërkojmë që ky pretendim të merret seriozisht dhe të bëhet rishqyrtimi i vendimit në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar, me parimet themelore të LPP-së dhe me praktikat e OSHP-së.

**Pretendimi 6- Mos lejimi dhe/ose neglizhimi i qasjes në dokumenteve zyrtare**

Mos qasja në dokumentet e kërkuara shton dyshimin se **OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm**, gjë për të cilat nuk mundemi ne ti verifikojmë në këtë gjendje të cilën jemi.

Gjithashtu kërkojmë që edhe ky pretendim të merret seriozisht dhe të bëhet rishqyrtimi i vendimit në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar dhe kërkesat e tenderit.

**Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me vetëdije ka bërë shkelje flagrante të LPP-së dhe Rregullores Nr. 002/2024 e cila rregullore është vazhdimësi e LPP-së.**

Gjithashtu Autoriteti Kontraktues nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, duke na diskriminuar neve si **Operator Ekonomik të përgjegjshëm me çmimin më të lirë,** edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi por po shihet se qëllimi i AK-së është që ne mos të shpallemi fitues. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo AK nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Po ashtu Autoriteti Kontraktues nuk e ka respektuar edhe nenin 6 të LPP-së edhe pse autoritetet kontraktuese janë të obliguar që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Autoritet Kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duhet të keni në konsideratë se oferta jonë është me e lirë se oferta të cilën AK e ka rekomanduar për të shpërblyer me kontratë, andaj Autoriteti Kontraktues në mënyrë të vetëdijshme ka tentuar të dëmtoj buxhetin e Republikës së Kosovës për **8,903.78 euro,** duke mos bërë një vlerësim të drejtë dhe korrekte të kësaj procedure.

Si përfundim, duke qenë se kemi plotësuar **të gjitha kërkesat** dhe për më tepër, kemi dëshmuar **kapacitet të mbi mjaftueshëm**, vlerësojmë se vendimi për eliminimin tonë është **i pabazuar dhe i pa-arsyetuar**, duke na privuar padrejtësisht nga konkurrenca pasi jemi në përputhje të plotë, madje kemi tejkaluar kërkesat e përcaktuara në **Njoftimin për Kontratë** dhe **Dosjen e Tenderit**.

Kërkojmë nga ju si **OSHP** që të nxjerrni:

**VENDIM**

**APROVOHET**, e bazuar kërkesa për rishqyrtim e **OE NIKA PrO- Ing SH.P.K, Rr.Rexhep Bislimi, 70000, Ferizaj, Kosovë**

**ANULOHET**, njoftimi mbi vendimin e AK-së nga KOMUNA FERIZAJ, dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM**, dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

**Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.**

## 8. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgaditjen dhe dorëzimin e ofertës, përgaditja e kërkesës për rishqyrtim, në vlerë prej 10,000.00 euro.

## 9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

*a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
*b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
*c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mospara-kualifikim.*
*d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*

NIKA PROING

# Kërkesë për qasje

**Për: KOMUNA FERIZAJ, DËSHMORËT E KOMBIT 70000 FERIZAJ**

Zyra e prokurimit: znj. Arbërie Bekteshi

Nga: NIKA PrO- Ing SH.P.K., Rr.Rexhep Bislimi, 70000, Ferizaj

Kërkojmë të na lejoni qasje në projektin:

**Titulli: Ndertimi i mureve mbrojtese ne fshatrat Nerodime, Dremjak, Mirosale dhe Gaçke.**

**Nr. i prokurimit: 656-25-2239-5-2-1**

Në bazë të Nenit 10 të Ligjit për Prokurim Publik dhe Nenit 7 të Rregullorës nr 002/2024, kërkojmë qasje në dokumentacion e OE të shpallur fitues, letër sqarimet nëse keni me OE të rekomanduar për kontratë si dhe gjithë dokumentacionin e kësaj procedure duke përfshirë raportin e vlerësimit, vërtetimet e Gjykatës dhe ATK-së.

Nika Pro-Ing Sh.P.K.

NIKA PRO-ING SH.P.K FERIZAJ

**Shpend Musa**
Drejtor

30.04.2025

Gmail

Nika Proing <nika.proing@gmail.com>

# Kerkese per qasje

2 messages

**Nika Proing** <nika.proing@gmail.com>
To: Prokurimi Ferizaj <prokurimi.ferizaj@rks-gov.net>

Fri, May 2, 2025 at 3:51 PM

Pershendetje te nderuar,

Po ju drejtohemi me kerkese per qasje per projektin: "**Ndertimi i mureve mbrojtese ne fshatrat Nerodime, Dremjak, Mirosale dhe Gaçke**" me nr. prokurimit **656-25-2239-5-2-1**, kerkese te cilen ju kemi bere edhe permes platformes se e-prokurimit me date 30.04.2025 por qe nuk kemi pranuar pergjigje. Per shkak te afatit, ju lusim qe qasjen ta kemi te henen paradite.

Bashkengjitur gjeni kerkesen.

Gjithe te mirat

---
"Nika Proing" Sh.p.k
044/249-864
048/720/261
nika.proing@gmail.com

**Kerkese per qasje (1).pdf**
127K

**Prokurimi Ferizaj** <Prokurimi.Ferizaj@rks-gov.net>
To: Nika Proing <nika.proing@gmail.com>

Mon, May 5, 2025 at 1:14 PM

Pershendetje i nderuar,

Ju mund te keni çasje per cdo dite pune prej ores 09:00 - 15:00.

Me respekt,

Zyra e Prokurimit, Komuna Ferizaj.

---

**From:** Nika Proing <nika.proing@gmail.com>
**Sent:** Friday, May 2, 2025 3:51:04 PM
**To:** Prokurimi Ferizaj
**Subject:** Kerkese per qasje

[Quoted text hidden]